



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmena • Ombudsperson Institution

Ex officio

Rasti Nr. 731/2017

RAPORT ME REKOMANDIME

I

AVOKATIT TË POPULLIT

në lidhje me

Vendimin e Inspektoratit Policor të Kosovës, të datës 29 dhjetor 2017, për anulimin e procesit të rekrutimit për Inspektor/Hetues, të shpallur më 24 korrik 2017

Për: Z. Ramush Haradinaj
Kryeministër

Z. Flamur Sefaj, Ministër
Ministria e Punëve të Brendshme

Z. Hilmi Mehmeti, Kryshef Ekzekutiv
Inspektorati Policor i Kosovës

Prishtinë, më 29 janar 2018

Qëllimi i raportit

1. Ky raport ka këto qëllime kryesore:

- a. të vlerësojë vendimin e Ministrit të Punëve të Brendshme, z. Flamur Sefaj, të datës 6 nëntor 2017, për pezullimin e nënshkrimit të kontratave me kandidatët e suksesshëm në konkursin e Inspektoratit Policor të Kosovës për Inspektor/Hetues, me numër të referencës IPK/DO/01, i shpallur me datën 24 korrik 2017;
- b. të vlerësojë vendimin e Kryeshefit Ekzekutiv të Inspektoratit Policor të Kosovës, të datës 29 dhjetor 2017, për anulimin e procedurës së rekrutimit për pozitën Inspektor/Hetues;
- c. të vlerësojë nëse vendimi i Ministrit të Punëve të Brendshme (MPB), për pezullimin e nënshkrimit të kontratave me kandidatët e suksesshëm dhe kërkesa për anulimin e tërësishëm të procedurës së rekrutimit, përbën cenim të lirive dhe të drejtave të njeriut;
- d. t'i rekomandojë Inspektoratit Policor të Kosovës lidhur me rregullimin e kësaj çështjeje, në bazë të argumenteve të përmendura në këtë raport;

2. Ky raport është rezultat i hetimeve me vetiniciativë (ex officio) të Avokatit të Popullit, bazuar në komunikatën për media të MPB, nr. 97/2017, të datës 6 nëntor 2017, me titull "*Ministri Sefaj pezullon nënshkrimin e kontratave në konkursin e IPK Inspektor/Hetues*".

Baza kushtetuese dhe ligjore

3. Sipas nenit 135, paragrafi 3, të Kushtetutës "*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga organet e administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore*".
4. Sipas Ligjit Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, neni 16, paragrafi 4, "*Avokati i Popullit ka kompetencë të bëjë hetime . . . me iniciativën e vet (ex officio), nëse nga konstatimet, dëshmitë dhe faktet e paraqitura me parashtrësë ose nga njohuritë e fituara në mënyrë tjetër, ka bazë të rezultojë se nga ana e autoriteteve janë shkelur të drejtat dhe liritë e njeriut të përcaktuara me Kushtetutë, ligje dhe akte të tjera, si dhe me instrumente ndërkombëtare për të drejtat e njeriut*".
5. Gjithashtu, Ligji për Avokatin e Popullit, neni 18, par. 1 përcakton se Avokati i Popullit, mes të tjerash, ka edhe këto përgjegjësi:
 - "*të tërheqë vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t'u jepet fund rasteve të tilla dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e autoriteteve përkatëse në lidhje me rastet e tilla*" (pika 2);
 - "*të rekomandojë Qeverinë, Kuvendin dhe autoritetet tjera kompetente të Republikës së Kosovës për çështjet që kanë të bëjnë me avancimin dhe mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, barazisë dhe jo diskriminimit*" (pika 5);
 - "*t'i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta*" (pika 6);
6. Me dërgimin e këtij raporti tek institucionet përgjegjëse, Avokati i Popullit synon të

kryejë përgjegjësitë kushtetuese dhe ligjore, të përmendura më sipër.

Përshkrimi i rastit

7. Më 24 korrik 2017, Inspektorati Policor i Kosovës (më tej IPK) ka bërë shpalljen e rekrutimit për plotësimin e vendeve të lira të punës për pranimin e shtatëmbëdhjetë (17) pozitave me titull *Inspektor/Hetues*.
8. Procedurat e konkursit janë zhvilluar në bazë të dispozitave të *Udhëzimit Administrativ 1/2017 për procedurat lidhur me kushtet e punësimit dhe të punës për punonjësit e IPK* (më tej UA Nr. 1/2017). Kandidatët që i kanë plotësuar kriteret e kërkuara në konkurs i janë nënshtruar procedurave në testin me shkrim, testin fizik, intervistën me gojë dhe kontrollin shëndetësor dhe psikologjik, të përcaktuara sipas dispozitave të UA Nr.1/2017.
9. Më 20 tetor 2017, IPK ka publikuar listën e rezultateve të testimit dhe intervistimit të kandidatëve, me ç' rast janë njoftuar kandidatët të cilët i vazhdojnë procedurat e rekrutimit, ndërsa kandidatët e pakënaqur me rezultatin e publikuar janë njoftuar për mundësinë e paraqitjes së ankesës, brenda pesë (5) ditëve të punës nga dita e publikimit të rezultateve.
10. Më 3 nëntor 2017, IPK ka publikuar listën përfundimtare të kandidatëve të përzgjedhur, të cilët janë ftuar, që më 6 nëntor 2017, në ora 10:00, t'i nënshkruajnë kontratat e punës me punëdhënësin.
11. Më 6 nëntor 2017, MPB ka lëshuar komunikatë për media nr. 97/2017, sipas të cilës njoftohet se Ministri i MPB ka marrë vendim që të mos nënshkruhen kontratat me kandidatët e përzgjedhur në konkursin e shpallur më 24 korrik 2017 për pozitën Inspektor/Hetues.
12. Më 29 dhjetor 2017, Kryeshefi Ekzekutiv i IPK, sipas kërkesës së Ministrit të MPB, ka nxjerrë vendim nr. pro. 01/112/2754/1, sipas të cilit anulohet procedura e rekrutimit e shpallur me datën 24 korrik 2017 për plotësimin e vendeve të lira të punës për pozitën Inspektor/Hetues.

Procedura në Institucionin e Avokatit të Popullit

13. Më 10 nëntor 2017, Avokati i Popullit ka hapur hetimet ex officio lidhur me Vendimin e Inspektoratit Policor të Kosovës, të datës 29 dhjetor 2017, për anulimin e procesit të rekrutimit për Inspektor /Hetues, të shpallur më 24 korrik 2017.
14. Më 5 dhjetor 2017, Avokati i Popullit i është drejtuar me shkresë Ministrit të MPB, me ç' rast ka kërkuar informacione lidhur me bazën ligjore sipas të cilës është marrë vendimi për pezullimin e nënshkrimit të kontratave, e po ashtu ka kërkuar informacione se a janë respektuar dispozitat e UA Nr. 1/2017.
15. Më 19 dhjetor 2017, Ministri i MPB i ka kthyer përgjigje Avokatit të Popullit duke e njoftuar se vendimin për pezullimin e nënshkrimit të kontratave e ka marrë për shkak se ai dhe Kryeministri kanë pranuar ankesa të shumta nga kandidatët që nuk janë përzgjedhur në konkursin në fjalë. Më tej, Ministri ka njoftuar se është bazuar në nenin 10 të Ligjit Nr. 03/L-128 për Auditimin e Brendshëm, si dhe nenin 9 paragrafi 1, nënparagrafët 1.4, 1.5, dhe nenit 16 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të zyrës së Kryeministrit dhe ministrive. Ministri i MPB nuk ka dhënë

ndonjë sqarim lidhur me zbatimin apo mos-zbatimin e UA Nr.1/2017 për procedurat lidhur me kushtet e punësimit dhe të punës për punonjësit e IPK, në bazë të të cilit është shpallur konkursi.

16. Avokati i Popullit duke analizuar arsyetimin të cilin e ka dhënë Ministri i MPB, vlerëson se ky arsyetim është jo relevant me rastin konkret. Sipas arsyetimit, vendimi për pezullimin e nënshkrimit të kontratave mbështetet në nenin 10 të Ligjit Nr. 03/L-128 për Auditim të Brendshëm, nën ky që përcakton themelimin dhe funksionimin e njësisë për auditim të brendshëm, ndërsa njësitë e auditimit nuk duket se kanë ndonjë rol në këtë mes. Po ashtu, mbështetja e këtij vendimi në nenin 9 paragrafi 1, nën-paragrafët 1.4, 1.5, dhe nenit 16 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të zyrës së Kryeministrit dhe ministrive, dispozita këto krejtësisht jorelevante me procesin e rekrutimit, sepse neni 9 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.4 përcakton rolin e ministrave në sigurimin e shërbimeve të besueshme, transparente, të përgjegjshme dhe jodiskriminuese; ndërsa paragrafi 1.5 përcakton rolin e ministrave në krijimin dhe zbatimin e masave kundër mashtrimit dhe korrupsionit, si dhe nxitjen e vetëdijesimit kundër mashtrimit. Gjithashtu, neni 16 i kësaj Rregulloreje, të cilit i është referuar Ministri, flet për funksionet e Zyrës së Kryeministrit e që po ashtu është jorelevant me procesin e rekrutimit.
17. Avokati i Popullit dhe përfaqësuesit e tij kanë zhvilluar dy takime të ndara me Ministrin e MPB dhe përfaqësuesit e MPB për të shprehur shqetësimet lidhur me veprimet e Ministrit, të cilat do të mund të binin ndesh me ligjin dhe do të mund të cenonin të drejtat e njeriut.

Sfondi ligjor

18. IPK funksionon bazuar në Ligjin Nr. 03/L-231 për Inspektoratin Policor të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji për IPK). Ky ligj përcakton misionin, organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e IPK (neni 1).
19. Sipas Ligjit për IPK, IPK është institucion ekzekutiv në kuadër të MPB, i pavarur nga Policia e Kosovës dhe në varësi të drejtpërdrejtë të Ministrit. Ligji përcakton statusin e IPK-së si të depolitizuar (neni 6, paragrafi 2).
20. Neni 10, paragrafi 1 i Ligjit për IPK, përcakton se *“IPK funksionon nën autoritetin e Ministrit dhe nën kontrollin dhe mbikëqyrjen e Kryeshefit të IPK-së. Autoriteti i Ministrit nuk përfshinë menaxhimin operacional të IPK-së....”*. Ndërsa, paragrafi 2 i po të njëjtit nen parasheh se Ministri:
- 1) *përcakton objektivat strategjike vjetore të IPK-së, në përputhje me politikat shtetërore;*
 - 2) *siguron bashkërendimin e punës së IPK-së me Policinë dhe me strukturat e tjera të MPB-së, si dhe bashkëpunimin me çdo institucion tjetër që siguron informata si dhe më institucionet shtetërore homologe të vendeve të tjera, në bazë të marrëveshjeve;*
 - 3) *nxjerrë akte nënligjore për organizimin dhe funksionimin e IPK-së, në përputhje me këtë ligj dhe me ligjet tjera në fuqi;*
 - 4) *kërkon raporte, informacione dhe dokumente të tjera, që lidhen me detyrat e IPK-së.*

21. Neni 12, paragrafi 1 i Ligjit për IPK përcakton se: “Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së është autoriteti ekzekutiv apolitik në kuadër të IPK-së dhe autoriteti më i lartë administrativ, teknik dhe operacional i IPK-së”. Ndërsa, paragrafi 2 i po të njëjtit nen, përcakton se: “Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së është përgjegjës për:
- 1) administrimin dhe menaxhimin e gjithmbarshëm dhe sigurimin e zbatimit të funksioneve që i janë besuar IPK-së;
 - 2) organizimin dhe punësimin e personelit, nxjerrjen e udhëzimeve administrative dhe marrjen e vendimeve për çështjet që i përkasin funksioneve të IPK-së; **(theks i shtuar)**
 - 3) menaxhimin efektiv dhe efikas të resurseve që i janë besuar IPK-së”.
22. Neni 16 paragrafi 2 i Ligjit për IPK, përcakton se: “Procedurat, kushtet e punësimit dhe të punës për punonjësit e IPK-së rregullohen me akt nënligjor nga Ministri, që përfshin por nuk do të kufizohet edhe në ngritjen në karrierë, trajnimin dhe konfliktin e interesit.”
23. UA Nr. 1/2017 është nxjerrë nga MPB me qëllim të përcaktimit të procedurave të rekrutimit për punonjësit e rekrutimit, përfshirë kushtet e punësimit dhe të punës, pranimin, punën provuese, vlerësimin e rezultateve në punë, zhvillimin në karrierë, transferimin, orarin e punës, ndërprerjen dhe përfundimin e marrëdhënies së punës.
24. Ndërsa neni 48 i UA Nr. 1/2017 përcakton të drejtën për ankesë për kandidatët në procedurë rekrutimi në IPK e po ashtu edhe punonjësit e IPK që nuk pajtohen me vendimin e Komisionit për shqyrtimin e ankesave.

Analiza dhe vlerësimi i Avokatit të Popullit

25. Avokati i Popullit, duke u bazuar në dispozitat e sipërpërmendura të Ligjit për IPK vlerëson se IPK është institucion ekzekutiv në kuadër të MPB, i pavarur nga policia që funksionon nën autoritetin e Ministrisë dhe nën kontrollin dhe mbikëqyrjen e Kryeshefit Ekzekutiv të IPK-së.
26. Avokati i Popullit më tej vlerëson se Ligji për IPK ka bërë ndarjen e qartë në mes të kompetencave të Ministrisë dhe Kryeshefit Ekzekutiv të IPK-së dhe se ky i fundit është përgjegjës për organizimin dhe punësimin e personelit, nxjerrjen e udhëzimeve administrative dhe marrjen e vendimeve për çështjet që i përkasin funksioneve të IPK-së (neni 12, par 2, nën-paragrafi 2.2). Rrjedhimisht, Kryeshefi Ekzekutiv është subjekti përgjegjës i cili duhet ta bëjë organizimin punësimin të personelit.
27. Në lidhje me këtë, Avokati i Popullit vëren, se deri me nxjerrjen e vendimit për anulimin e procedurës së rekrutimit, Kryeshefi Ekzekutiv ka ushtruar kompetencat dhe përgjegjësitë e veta në pajtim me ligjin dhe UA Nr. 1/2017, që si rezultat ka pasur shpalljen e listës përfundimtare me kandidatët e suksesshëm, të cilët janë ftuar që më 6 nëntor 2017, të nënshkruajnë kontratat e punës.
28. Në bazë të përshkrimit të rastit vërehet se Ministri po të njëjtën ditë ka marrë vendim që të mos nënshkruhen kontratat me kandidatët e përzgjedhur, ndërsa Kryeshefi Ekzekutiv duke vepruar në bazë të kërkesës së Ministrisë, më 29 dhjetor 2017, ka nxjerrë vendim sipas të cilit anulohet procedura e rekrutimit për plotësimin e vendeve të lira të punës Inspektor/Hetues.

29. Avokati i Popullit vlerëson se kërkesa e Ministrit për anulimin e procedurës së finalizuar përbën tejkallim të kompetencave të tij ligjore. Po ashtu vendimi i Kryeshefit Ekzekutiv për anulimin e procedurës, sipas kërkesës së Ministrit, përbën tejkallim të kompetencave ligjore edhe nga ana e Kryeshefit Ekzekutiv.
30. Ndërmarrja e veprimeve të tilla, në fazën përfundimtare të një procesi, në këtë rast procedurës së rekrutimit edhe atë pas njoftimit të kandidatëve të suksesshëm, përveç që ka të bëjë me tejkallim të kompetencave, ngritë edhe një sërë çështjesh kushtetuese dhe ligjore, çështje këto mjaft shqetësuese nga pikëpamja e të drejtave të njeriut dhe sundimit të ligjit.
31. Ky konkluzion përforcohet edhe më shumë kur analizohet përgjigjja e Ministrit ndaj shkresës së Avokatit të Popullit, rreth arsyes dhe bazës ligjore në të cilën është bazuar ai për nxjerrjen e vendimit për pezullimin e nënshkrimit të kontratave me kandidatët e suksesshëm në procesin e rekrutimit. Sipas përgjigjes së Ministrit, si bazë për marrjen e vendimit për pezullimin e nënshkrimit të kontratave janë ankesat e shumta që ka pranuar ai dhe Kryeministri rreth procesit të rekrutimit.
32. Avokati i Popullit vëren së neni 48, paragrafi 5 i Udhëzimit Administrativ nr. 1/2017 i cili përcakton të drejtën për ankesë për kandidatët në procedurë rekrutimi në IPK, parasheh se:
- “Në një procedurë rekrutimi për punonjës të rinj, kandidati mund të paraqes ankesë brenda pesë (5) ditëve, në të gjitha fazat e procesit rekrutues. Ankesat trajtohen nga Komisioni përkatës, i cili themelohet nga Kryeshefit Ekzekutiv dhe i cili merr vendim brenda dy (2) ditëve të punës, nga momenti i pranimit të ankesës.”*
33. Lidhur me këtë, Avokati i Popullit tërheq vëmendjen se Ministri nuk ka legjitimitet që në situata të tilla të pranojë ankesa, sepse një gjë e tillë është në kompetencë të organeve të përcaktuara me ligj (shih UA, neni 48, par 4 dhe par 5).
34. Vendimi për anulimin e procedurës së rekrutimit nuk jap ndonjë sqarim se cila ka qenë arsyeja e anulimit. Madje, vendimi për anulim as për nga forma nuk i plotëson kriteret për t’u konsideruar një vendim i rregullt, i cili sipas Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative do të duhej t’i përmbajë elementet detyruese të aktit administrativ të shkruar (shih nenin 47 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative).
35. Avokati i Popullit konsideron se me anulimin e procedurës së rekrutimit janë shkelur së paku katër nga dhjetë parimet e Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.
36. Parimi i ligjshmërisë, neni 4 (paragrafi 1 dhe 2):
- 1. Organet publike veprojnë në përputhje me Kushtetutën, legjislacionin në fuqi, si edhe me rregullat e përgjithshme administrative të zbatueshme brenda kompetencave të tyre dhe në përputhje me qëllimin për të cilat janë dhënë këto kompetenca.*
- 2. Veprimi administrativ që cenon apo mund të cenojë një të drejtë apo interes juridik të një personi, duhet të jetë i autorizuar nga një ligj.*
37. Parimi i objektivitetit dhe paanësisë, neni 7:

1. *Organi publik duhet të veprojë në mënyrë objektive dhe të paanshme.*
 2. *Veprimet e zyrtarit publik nuk duhet të ndikohen nga ndonjë interes personal, familjar, miqësor, politik apo nga presioni politik.*
38. Parimi i pritshmërisë së ligjshme dhe të arsyeshme, neni 8:
1. *Veprimet e organeve publike duhet të jenë të parashikueshme dhe të respektojnë pritshmëritë legjitime dhe të arsyeshme të personave.*
 2. *Një veprim administrativ nuk mund të ndryshojë në mënyrë të pajustificuar nga një praktikë administrative e mëparshme e të njëjtit organ për raste të njëjta a të ngjashme.*
39. Parimi i të drejtës në mjete juridike, neni 13:
- Përveç kur përjashtohet shprehimisht me ligj, secili person ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative dhe ato gjyqësore, në mënyrën e përcaktuar me ligj, kundër një veprimi apo mosveprimi administrativ të organit publik që i cenon një të drejtë apo një interes juridik.*
40. Parimi i ligjshmërisë, parimi i objektivitetit dhe paanësisë, parimi i të drejtës në mjete juridike, të përcaktuara me Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative përbëjnë elemente qenësore të një procesi të rregullt.
41. E drejta në një proces të rregullt është e përcaktuar edhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut të cilat sipas nenit 22 të Kushtetutës janë drejtpërdrejtë të zbatueshme në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve të tjera të institucioneve publike.
42. E drejta në një gjykim të drejtë dhe të paanshëm përcaktohet me nenin 31, paragrafi 1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, sipas të cilit: “Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike”. Po ashtu neni 6, paragrafi 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut do të thotë që “[ç]do person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht....nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile...”
43. Është e domosdoshme të vlerësohet nëse, sipas praktikës së Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), çështjet e punësimit bien në domenin e nenit 6 të KEDNJ. Sipas Ligjit për IPK, disa aspekte raportet nga marrëdhëniet e punës për punonjësit e IPK-së rregullohen sipas kriterëve të shërbimit civil. Në lidhje me mosmarrëveshjet për marrëdhëniet e punës në shërbimin civil, saktësisht ato në lidhje me rekrutimin, karrierën, përfundimin e shërbimit, GJEDNJ fillimisht kishte vendosur rregullin e përgjithshëm se ato nuk përfshiheshin brenda nenit 6 të KEDNJ. Megjithatë, në çështjen *Pellegrin kundër Francës*, GJEDNJ nisi të largohej nga ky rregull duke miratuar kriteret e zbatueshme rast pas rasti, të cilat lidheshin me natyrën e detyrave dhe përgjegjësisë të punëmarrësit. GJEDNJ e pakënaqur me rezultatet e pazakonta në çështjet që pësuan ata Pellegrin, GJEDNJ qartësoi kriteret e vlerësimit në çështjen *Eskelinen dhe të tjerët kundër Finlandës*. Që një mosmarrëveshje në lidhje me marrëdhëniet e punës në shërbimin civil të mos gjykohej sipas nenit 6 të KEDNJ-së: (1) shteti duhet të ketë parashikuar

shprehimisht në ligjin vendas mundësinë për t'iu drejtuar gjykatës, dhe (2) përjashtimi duhet justifikuar me arsye të objektive në interes të shtetit që do të thotë se ekziston një lidhje e veçantë besimi dhe besnikërie midis nëpunësit civil dhe shtetit dhe se objekti i mosmarrëveshjes lidhet me ushtrimin e funksioneve të shtetit ose ka vënë në pikëpyetje lidhjen e veçantë (*Vihlo Eskelinen dhe të tjerët kundër Finlandës*, GJEDNJ, 19 prill 2007, paragrafi 62).¹

44. Meqenëse, nga veprimet lidhur me anulimin e procedurës së rekrutimit nuk ka indikacione se për punonjësit e IPK-së mundësia për t'iu drejtuar gjykatës është përjashtuar shprehimisht me ndonjë akt normativ, rasti konkret bie në domenin e fushëveprimit të nenit 6 të KEDNJ.
45. Në kuptimin e KEDNJ dhe praktikës së GJEDNJ, gjykatë e pavarur dhe e paanshme është gjykata apo organi administrativ të cilit ligji i ka dhënë kompetenca për të vlerësuar dhe për të vendosur për të drejtat e individëve. Në këtë rast organet që vendosin për ankesat e kandidatëve janë përcaktuar me nenin 48 të UA. Nr. 1/2017. Ankesat e kandidatëve të pakënaqur në procedurën administrative trajtohen nga Komisioni për shqyrtimin e ankesave të emëruar nga Kryeshefi Ekzekutiv i IPK-së, ndërsa kontrolli gjyqësor i vendimeve administrative bëhet nga gjykata dhe se i tërë ky proces në gjykatë i nënshtrohet pastaj shumë shkallshmërisë deri në Gjykatën Supreme.
46. Në qoftë se pretendimet e Ministrit për ankesat që i ka pranuar nga kandidatët e pakënaqur, janë të sakta, atëherë Ministri do të duhej të përmbahej nga çfarëdo veprimi lidhur me këto ankesa, aq më parë për shkakun se kandidatët e pakënaqur janë njoftuar për mundësinë e paraqitjes së ankesës (shih pikën 9 të këtij raporti).
47. Në anën tjetër, veprimet e paautorizuara për anulimin e procedurës së rekrutimit dëmtojnë interesin dhe të drejtat e kandidatëve të përzgjedhur sepse ata kanë krijuar pritshmëri legjitime dhe të arsyeshme. Koncepti i pritshmërisë legjitime dhe të arsyeshme në mbrojtjen e të drejtave subjektive është një koncept gjithëpërfshirës interpretimi në praktikën gjyqësore ndërkombëtare. Sipas GJEDNJ-së (*shih rastet Kopecky v. Slovakia, Aktgjykimi i datës 28 shtator 2004, para 45-52; Gratzinger dhe Gratzingerova kundër Republikës Çeke (dec.), nr. 39794/98, para 73, GJEDNJ 2002-VII*), “pritshmëria legjitime” duhet të jetë e një natyre konkrete dhe duhet të bazohet në dispozita ligjore dhe në akte ligjore. Në rastin aktual, pritja legjitime e kandidatëve të përzgjedhur bazohet në Ligjin për IPK-në dhe UA Nr. 1/2017, si dhe në njoftimin e IPK-së me të cilin ata ishin shpallur si kandidatët e suksesshëm, të cilët edhe ishin ftuar për të nënshkruar kontratat e punës.
48. Vendimi për anulimin e procedurës së rekrutimit është një vendim i pajustificuar dhe paarsyetuar. E drejta në një vendim të arsyetuar është e rrënjësor si parim i përgjithshëm në KEDNJ, e që mbron individët nga arbitrariteti. Vendimi duhet të përmbajë arsyetim të mjaftueshëm në mënyrë që t'i përgjigjet argumenteve procedurale dhe materiale të palëve (*Ruiz Torija v. Spain, §§29-30*). Vendimi për anulim të procedurës, edhe në rast se është nxjerrë për të adresuar ankesat e kandidatëve të pakënaqur, ai nuk merret fare me aspektet procedurale dhe materiale të ankesave të ngritura nga kandidatët e pakënaqur.

¹ Manual për Monitorimin e Drejtësisë Administrative, OSBE, Tiranë, shkurt 2015, fq 41

49. Avokati i Popullit shpreh shqetësimin e tij se veprime të tilla të pajustificueshme dhe arbitrare, shmangia nga normat që rregullojnë procedura të caktuara krijojnë pasiguri juridike. Pasiguria juridike nënkupton një situatë kur te individi krijohet përshtypja se drejta e tij/saj do të mund të varet nga çfarëdo veprimi tjetër, por jo nga ligji.
50. Pjesë e një procesi të rregullt konsiderohet edhe e drejta në zgjidhjen efektive, e drejtë kjo e garantuar me Kushtetutë [E Drejta në Mjete Juridike], neni 32 sipas të cilit "*Secili person ka të drejtë të përdorë mjetet juridike kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative të cilat cenojnë të drejtat ose interesat e saj/tij në mënyrën e përcaktuar me ligj*". Fryma e nenit 32 të Kushtetutës është përcjellë edhe te neni 13 i Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative (shih parimin e të drejtës në mjete juridike). E drejta në mjete efektive juridike është përcaktuar edhe me nenin 13 të KEDNJ, sipas të cilit: "*Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare.*"
51. Zgjidhje efektive do të thotë mekanizëm i duhur dhe funksional gjyqësor dhe administrativ për të trajtuar dhe vendosur mbi pretendimet për shkelje sipas ligjit vendas. Ky parim zbatohet edhe për shkeljet e kryera nga personat zyrtarë gjatë kryerjes së detyrës. Zgjidhje efektive nuk mund të konsiderohen të tilla kur janë një iluzion për shkak të kushteve të përgjithshme në vend, kur janë shumë të mundimshme për personin, të cilit i janë shkelur të drejtat ose kur shteti nuk siguron zbatimin e duhur të tyre nga autoritet gjyqësore. Gjithashtu, nëse një gjykatë refuzon të shqyrtojë çështjet substanciale në lidhje me një veprim administrativ të një organi ekzekutiv të cilin e konsideron se po ushtron detyrat e tij, ankesa nuk mund të konsiderohet si zgjidhje efektive (*Hasan dhe Chaush kundër Bullgarisë*, GJEDNJ, 26 tetor 2000, paragrafi 100). Po ashtu, nëse një organ administrativ nuk zbaton një vendim në favor të një pale të interesuar, kundërshtimi në gjykatë bëhet një zgjidhje jo efektive (po aty, paragrafi 101). Shteti e ka barrën e provës për të provuar se zgjidhja është efektive (po aty, paragrafi 102).²
52. Vendimi për anulimin e procedurës së rekrutimit demonstroi dështimin e autoriteteve, në këtë rast Ministrin të MPB dhe Kryeshefit Ekzekutiv të IPK-së, për të qenë objektiv dhe të paanshëm gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre me çka vihet në konstatimin se ka pasur ndërhyrje në të drejtat e kandidatëve të suksesshëm për të themeluar marrëdhënie të punës të garantuar me nenin 49 të Kushtetutës.
53. Ky konstatim gjen mbështetje në vendimin për anulim, në pjesën hyrëse të tij, ku thuhet se vendimi në mes tjerash është marrë "me kërkesën e Ministrin të Punëve të Brendshme".
54. Avokati i Popullit vë në pah se shteti në raste të caktuara ka të drejtë të ndërhyjë në të drejtat e garantuara, por çfarëdo ndërhyrje dhe kufizim i këtyre të drejtave mund të bëhet "vetëm me ligj" dhe kur këto kanë "qëllime legjitime" të cilat janë "të domosdoshme për një shoqëri demokratike".
55. Nga dispozitat ligjore të analizuar më sipër nuk vërehet se autoriteteve përgjegjëse i është dhënë autorizimi për të ndërhyrë në të drejtat e garantuara. Prandaj, mund të thuhet se veprimet përkitazi me anulimin e procedurës së rekrutimit jo vetëm që paraqesin

² Manual për Monitorimin e Drejtësisë Administrative, OSBE, Tiranë, shkurt 2015, fq 49

ndërhyrje, por këto ndërhyrje janë në kundërshtim me ligjin dhe tejkalojnë autorizimet të cilat u janë dhënë Ministrit të MPB dhe Kryeshefit Ekzekutiv të IPK.

56. Sipas Kushtetutës ministritë dhe organet tjera ekzekutive kryejnë funksionet brenda kompetencave të Qeverisë. Një ndër këto funksione është marrja e vendimeve, nxjerrja e akteve juridike ose rregulloreve, të nevojshme për zbatimin e ligjit. Ndërsa vendimi për anulimin e procedurës së rekrutimit në fazën finale të kësaj procedure, pengon zbatimin e ligjit.

57. Së këndejmi, Avokati i Popullit vlerëson se Vendimi i Ministrit të MPB për anulimin e nënshkrimit të kontratave me kandidatët e suksesshëm, dhe kërkesa e Ministrit të MPB për nxjerrjen e vendimit nga Kryeshefi Ekzekutiv të IPK për anulimin e procesit të rekrutimit, i datës 29 dhjetor 2017, përbëjnë veprime që cenojnë:

- Të drejtën e kandidatëve në punë dhe në ushtrimin e profesionit;
- Të drejtën në një gjykim të drejtë dhe të paanshëm; dhe
- Të drejtën në mjete efektive juridike

Në bazë të këtyre konstatimeve dhe në përputhje me nenin 135, par. 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 16, par. 4 të Ligjit Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit i:

Rekomandon:

1. Ministrit të Punëve të Brendshme, të tërheq kërkesën me të cilën ka kërkuar nga Kryeshefi Ekzekutiv anulimin e procesit të rekrutimit në IPK.

2. Kryeshefit Ekzekutiv të Inspektoratit Policor të Kosovës, që në pajtim me përgjegjësitë e tij të përcaktuara me Ligjin për Inspektoratin Policor të Kosovës dhe në pajtim me Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative të ndërmarrë veprime për anulimin e Vendimit nr.pro. 01/112/2754/1, të datës 29 dhjetor 2017; dhe

3. Ministritë të Punëve të Brendshme që të përmbahet nga ndërhyrjet në organizimin dhe punësimin e personelit dhe marrjen e vendimeve për çështjet që i përkasin funksioneve të IPK-së.

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj”) dhe nenin 28 të Ligjit Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, . . . duhet të përgjigjen brenda afatit të caktuar kohor. Përgjigjja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë”), mirësisht Ju lutemi të na informoni për veprimet që do të ndërmerrni lidhur me këtë çështje.

Me nderime,

Hilmi Jashari

Avokat i Popullit